

## 1. Identifikimi

<b>Identifikuesi GHS i produktit</b>	<b>OREAS 70B</b>
<b>Kodi i produktit</b>	Q0203078
<b>Versioni nr.</b>	01
<b>Data e publikimit</b>	26 shkurt 2019
<b>Data e rishikimit</b>	-
<b>Zëvendëson datën</b>	-
<b>CAS #</b>	Përzjerje
<b>Përdorimi i rekomanduar</b>	Përdoret si standard kontrolli për kalibrimet e dheut dhe gjeokimike.
<b>Kufizimet e rekomanduara</b>	Nuk disponohet.
<b>Fabrikanti</b>	
<b>Emri i kompanisë</b>	OLYMPUS EUROPA SE & CO. KG
<b>Adresa</b>	Wendenstraße 14-18 20097 Hamburg Germany
<b>Numri i telefonit</b>	+49 40-23773-3482
<b>Faks</b>	+49 40-23773-503482
<b>1.4. Numri i telefonit për urgjencë</b>	CHEMTREC  SHBA: 1-800-424-9300, Ndërkombëtar: +1-703-527-3887

## 2. Identifikimi i rrezikshmërive

### Klasifikimi GHS

<b>Rrezikshmëritë fizike</b>	I paklasifikuar.	
<b>Rrezikshmëritë shëndetësore</b>	Përndjeshmimi, lëkura	Kategoria 1
	Mutagenicitet i qelizave germinale	Kategoria 2
	Kancerogjeniteti	Kategoria 1A
	Toksiciteti specifik për organin e shënjestruar, ekspozim i përsëritur	Kategoria 1
<b>Rrezikshmëritë mjedisore</b>	Me rrezikshmëri për mjedisin ujor, rrezikshmëri akute	Kategoria 3
	Me rrezikshmëri për mjedisin ujor, rrezikshmëri afatgjatë	Kategoria 3

### Elementet e etiketës GHS

**Fjala sinjalizuese** Rrezik



**Deklarata e rrezikshmërisë** Mund të shkaktojë një reaksion alergjik të lëkurës. Dyshohet se shkakton defekte gjenetike. Mund të shkaktojë kancer. Shkakton dëmtime të organeve përmes ekspozimit të zgjatur ose të përsëritur. I dëmshëm për gjallesat ujore me efekte afatgjata.

### Deklarata paralajmëruese

<b>Parandalimi</b>	Njihuni me udhëzimet e posaçme para se ta përdorni. Mos e trajtoni para se të keni lexuar dhe kuptuar të gjitha masat paraprake të sigurisë. Mos frymëthithni pluhurin. Lani me kujdes pas trajtimit. Mos hani, mos pini dhe mos ndizni duhan kur po e përdorni këtë produkt. Rrobot e punës të ndotura nuk duhen nxjerrë jashtë vendit të punës. Shmangni çlirimin në mjedis. Përdorni doreza mbrojtëse/ veshje mbrojtëse/ mbrojtje për sytë/ mbrojtje për fytyrën.
<b>Përgjigjja</b>	PO TË PREKË LËKURËN: Lani me ujë të bollshëm. NË RAST ekspozimi, ose po të ndiheni i/e prekur: Kërkoni këshilla/ ndihmë mjekësore. Në qoftë se ndodh irritim ose skuqe e lëkurës: Kërkoni këshilla/ ndihmë mjekësore. Hiqini rrobat e ndotura dhe lajini para se t'i përdorni përsëri.
<b>Magazinimi</b>	Ruajeni të mbyllur me çelës.
<b>Eliminimi</b>	Eliminoni përmbajtjen/ enën në pajtim me rregulloret lokale/ rajonale/ kombëtare/ ndërkombëtare.
<b>Rrezikshmëri të tjera që nuk figurojnë në klasifikim</b>	Asnjë që njihet.
<b>Informacion shtesë</b>	Asnjë.

### 3. Përbërja/ të dhëna për përbërësit

Përbërësit	CAS #	Për qind
Mineral masiv sulfur nikeli të gradës së lartë dhe material ultramafik të zhveshur (-)	-	100
Pjesët përbërëse	CAS #	Për qind
Quarc	14808-60-7	-
Sulfur nikeli	16812-54-7	-

**Komente për përbërjen** Vlerësimi i rrezikshmërisë bazohet te përmbajtja në sulfur nikeli.

### 4. Masa të ndihmës së parë

#### Procedura të ndihmës së parë

<b>Frymëthithja</b>	Zhvendosuni në ajër të pastër. Telefononi një mjek, nëse simptomat shfaqen ose vazhdojnë.
<b>Lëkura</b>	Hiqni menjëherë rrobat e ndotura dhe lajini lëkurën me sapun dhe ujë. Në rast ekzeme ose çrregullimesh të tjera të lëkurës: Kërkoni ndihmë mjekësore dhe mbajini këto udhëzime me vete.
<b>Sytë</b>	Mos i fërkoni sytë. Shpëlani me ujë. Kërkoni ndihmë mjekësore, nëse zhvillohet dhe vazhdon irritimi.
<b>Gëlltitje</b>	Shpëlajeni gojën. Kërkoni ndihmë mjekësore, nëse shfaqen simptoma.
<b>Simptomat dhe efektet më të rëndësishme, akute dhe të vonuara</b>	Pluhurat mund të iritojnë rrugët e frymëmarrjes, lëkurën dhe sytë. Mund të shkaktojë një reaksion alergjik të lëkurës. Dermatit. Urtikarie. Ekspozimi i zgjatur mund të shkaktojë efekte kronike.
<b>Shënime për mjekun</b>	Ofroni masa mbështetëse të përgjithshme dhe trajtoni sipas simptomave. Mbajeni viktimën nën vëzhgim. Simptomat mund të shfaqen me vonesë.
<b>Këshillë e përgjithshme</b>	NË RAST ekspozimi, ose po të ndiheni i/e prekur: Kërkoni këshilla/ ndihmë mjekësore. Në qoftë se nuk ndiheni mirë, kërkoni ndihmë nga mjeku (tregoni etiketën nëse mundeni). Sigurohuni që personeli mjekësor është në dijeni të materialeve të përdorura dhe po marrin masa për t'u mbrojtur. Tregojani këtë dëftesë të sigurisë teknike mjekut të shërbimit. Lajini rrobat e ndotura para se t'i përdorni përsëri.

### 5. Masa të mbrojtjes kundër zjarrit

**Mjete fikëse të përshtatshme** Përdorni mjete zjarrfikëse të përshtatshme për materialet rrethuese.

**Mjete fikëse të papërshtatshme** Asnjë që njihet.

**Rrezikshmëri specifike të kimikatit** Asnjë që njihet.

**Pajisjet mbrojtëse dhe masat mbrojtëse për zjarrfikësit** Në rast zjarri, duhet mbajtur aparat frymëmarrjeje autonom dhe veshje mbrojtëse e plotë.

**Mbrojtja e zjarrfikësve** Spërkatni me ujë për të ftohur enët e pahapura.

### 6. Masa në rast çlirimi aksidental

**Masa mbrojtëse personale** Mbajeni larg personelin e panevojshëm. Mbajini njerëzit larg nga derdhja/rrjedhja dhe kundër erës. Përdorni

pajisje mbrojtëse dhe veshje të përshtatshme gjatë pastrimit. Mos frymëthithni pluhurin. Mos i prekni enët e dëmtuara ose materialin e derdhur, në qoftë se nuk mbani veshje mbrojtëse të përshtatshme. Siguroni ajrim të mjaftueshëm. Në qoftë se derdhjet janë të mëdha dhe nuk mund të kontrollohen, duhen njoftuar autoritetet lokale. Për mbrojtje personale, shihni seksionin 8 të kësaj SDS-je.

## Masa mbrojtëse mjedisore

Shmangni çlirimin në mjedis. Njoftoni personelin e duhur menaxherial ose mbikëqyrës për çdo lloj çlirimi në mjedis. Parandaloni rrjedhjen ose derdhjen e mëtejshme, nëse mund ta bëni këtë në mënyrë të sigurtë. Shmangni shkarkimin në kanale shkarkimi, rrjedha uji ose në tokë.

## Metodat e kontrollit të derdhjeve

Ndalen rrjedhën e materialit, nëse mund ta bëni këtë pa rrezik.

## Metodat e pastrimit

Ajrojeni zonën e ndotur. Minimizoni përfitim dhe grumbullimin e pluhurit. Shmangni përfitim dhe pluhurave gjatë pastrimit. Mblidheni pluhurin me anë të një aspiratori të pajisur me filtër HEPA. Përdorni pajisje mbrojtëse dhe veshje të përshtatshme gjatë pastrimit. Mos lejoni që produkti të futet në ujërat e bardha. Mos lejoni që materiali të ndotë sistemin e ujërave nëntokësore. Ndalen rrjedhën e materialit, nëse mund ta bëni këtë pa rrezik. Derdhje të mëdha: Njomni me ujë dhe argjinoni për eliminim të mëvonshëm. Hidheni materialin me lopatë të një kosh mbeturinash. Pasi ta rikuperoni produktin, shpëljajeni zonën me ujë.

Derdhje të vogla: Fshijeni materialin e derdhur ose thitheni me makinë fshirëse dhe mblidheni në një enë të përshtatshme për eliminim. Për eliminim dhe mbetjeve, shihni seksionin 13 të kësaj SDS-je. Shmangni shpërhapjen e pluhurit në ajër (d.m.th., pastrimin e sipërfaqeve të pluhurta me ajër të ngjeshur).

Asnjëherë mos i ktheni derdhjet në enët origjinale, për ri-përdorim. Vendoseni materialin në enë të përshtatshme, të mbuluara dhe të etiketuara.

## 7. Trajtimi dhe magazinimi

### Trajtimi

Njihuni me udhëzimet e posaçme para se ta përdorni. Mos e trajtoni para se të keni lexuar dhe kuptuar të gjitha masat paraprake të sigurisë. Minimizoni përfitim dhe grumbullimin e pluhurit. Ofroni ajrim me shkarkim të mjaftueshëm, në vendet ku krijohet pluhur. Mos frymëthithni pluhurin. Shmangni kontaktin me sytë, lëkurën dhe veshjen. Gjatë përdorimit, mos hani, mos pini dhe mos tymosni. Duhet trajtuar në sisteme të mbyllura, nëse kjo është e mundur. Përdorni pajisje mbrojtëse personale të përshtatshme. Lani mirë duart pas trajtimit. Shmangni çlirimin në mjedis. Adoptoni praktika të higjienës së mirë industriale.

### Magazinimi

Ruajeni të mbyllur me çelës. Ruajeni në një enë të mbyllur mirë. Magazinoni në një vend të ajrosur mirë. Mbajeni larg materialeve të papajtuashme (shihni Seksionin 10 të SDS).

## 8. Kontrollë të ekspozimit / mbrojtja personale

### Parametrat e kontrollit

#### SHBA. Vlerat cak të pragut ACGIH

Pjesët përbërëse	Lloji	Vlera	Forma
Sulfur nikeli (CAS 16812-54-7)	TWA	0.2 mg/m <sup>3</sup>	Fraksion i frymëthithshëm.
Kuarc (CAS 14808-60-7)	TWA	0.025 mg/m <sup>3</sup>	Fraksion i frymëmarrshëm.

### Vlerat e caqeve biologjike

Nuk shënohen caqe ekspozimi biologjik për përbërësin/t.

### Procedurat e rekomanduara të monitorimit

Ndiqni procedurat standard të monitorimit.

### Kontrollet inxhinierike

Duhet përdorur ajrim i mirë i përgjithshëm. Shpejtësia e ajrimit duhet të përkojë me rrethanat. Nëse kjo mund të bëhet, përdorni hapësira të mbyllura përpunimi, ajrim me shkarkim lokal ose kontrolle të tjera inxhinierike, për të mbajtur nivelet e ndotjes ajrore nën caqet e rekomanduara të ekspozimit. Në qoftë se nuk janë vendosur caqe ekspozimi, mbajeni ndotjen ajrore në një nivel të pranueshëm. Në qoftë se materiali bluhet, pritjet ose përdoret në ndonjë operacion tjetër që mund të përtojë pluhur, përdorni ajrim lokal me shkarkim për ta mbajtur ekspozimin nën caqet e rekomanduara të ekspozimit.

### Pajisjet mbrojtëse personale

#### Mbrojtja për sytë/fytyrën

Përdorni syze mbrojtëse të ngjeshura pas fytyrës, nëse përftohet pluhur.

#### Mbrojtja për lëkurën

Mbani veshje të përshtatshme, rezistente ndaj kimikateve. Rekomandohet përdorimi i një përparëseje të papërshkueshme.

#### Mbrojtja për frymëmarrjen

Përdorni respirator me filtër pluhuri.

#### Mbrojtja për duart

Mbani dorashka të përshtatshme, rezistente ndaj kimikateve.

## 9. Vetitë fizike dhe kimike

### Pamja

<b>Gjendja e lëndës</b>	E ngurtë.
<b>Ngjyra</b>	Nuk disponohet.
<b>Forma</b>	Pluhur.
<b>Aroma</b>	Nuk disponohet.
<b>Pragu i aromës</b>	Nuk disponohet.
<b>pH</b>	Nuk disponohet.
<b>Pika e shkrirjes/pika e ngrirjes</b>	Nuk disponohet.
<b>Pika e vlimit</b>	Nuk disponohet.
<b>Pika e flakërimit</b>	Nuk zbatohet.
<b>Shpejtësia e avullimit</b>	Nuk zbatohet.
<b>Ndezshmëria (e ngurtë, gaz)</b>	Ky material nuk digjet.
<b>Caqet e ndezshmërisë në ajër, i ulëti, % sipas volumit</b>	Nuk disponohet.
<b>Caqet e ndezshmërisë në ajër, i lartë, % sipas volumit</b>	Nuk disponohet.
<b>Trysnia e avullit</b>	Nuk zbatohet.
<b>Dendësia e avullit</b>	Nuk zbatohet.
<b>Dendësia relative</b>	Nuk disponohet.
<b>Tretshmëria/të</b>	
<b>Tretshmëria (në ujë)</b>	I patretshëm në ujë.
<b>Koeficienti i përndarjes (n-oktanol/ujë)</b>	Nuk disponohet.
<b>Temperatura e vetëndezjes</b>	Nuk zbatohet.
<b>Temperatura e shpërbërjes</b>	Nuk disponohet.
<b>Viskoziteti</b>	Nuk disponohet.
<b>Të dhëna të tjera</b>	
<b>Vetitë shpërthyes</b>	Jo shpërthyes.
<b>Vetitë oksiduese</b>	Jo oksidues.

## 10. Qëndrueshmëria dhe reaktiviteti

<b>Reaktiviteti</b>	Produkti është i qëndrueshëm dhe jo-reaktiv në kushte normale përdorimi, magazinimi dhe transportimi.
<b>Qëndrueshmëria kimike</b>	Materiali është i qëndrueshëm në kushte normale.
<b>Mundësi reaksionesh të rrezikshme</b>	Nuk njihen reaksione të rrezikshme në kushtet e përdorimit normal.
<b>Rrethana për t'u shmangur</b>	Kontakti me materiale të papajtueshme.
<b>Materiale të papajtueshme</b>	Oksidues të fuqishëm. Klorinë.
<b>Produkte të rrezikshme të shpërbërjes</b>	Nuk njihen produkte të rrezikshme të shpërbërjes.

## 11. Informacion toksikologjik

<b>Rrugët e ekspozimit</b>	Frymëthithja. Kontakti me lëkurën. Kontakti me sytë.
<b>Toksiciteti akut</b>	Nuk pritet të ketë toksicitet akut.

<b>Gërryerje/ irrimim i lëkurës</b>	Kontakti i zgjatur me lëkurën mund të shkaktojë irrimim të përkohshëm.
<b>Dëmtim/ irrimim serioz i syve</b>	Kontakti i drejtpërdrejtë me sytë mund të shkaktojë irrimim të përkohshëm.
<b>Përndjeshmues i rrugëve të frymëmarrjes</b>	Nuk është përndjeshmues i rrugëve të frymëmarrjes.
<b>Përndjeshmimi i lëkurës</b>	Mund të shkaktojë një reaksion alergjik të lëkurës.
<b>Mutagjeniciteti</b>	Dyshohet se shkakton defekte gjenetike.
<b>Kancerogjeniteti</b>	Mund të shkaktojë kancer.
<b>Kancerogjenët ACGIH</b>	
Sulfur nikeli (CAS 16812-54-7)	A1 Kancerogjen i konfirmuar për njerëzit.
Kuarc (CAS 14808-60-7)	A2 Kancerogjen i dyshuar për njerëzit.
<b>Monografitë IARC. Vlerësimi i përgjithshëm i kancerogjenitetit</b>	
Sulfur nikeli (CAS 16812-54-7)	1 Kancerogjen për njerëzit.
Kuarc (CAS 14808-60-7)	1 Kancerogjen për njerëzit.
<b>Toksiciteti riprodiktiv</b>	Ky produkt nuk pritet të shkaktojë efekte në riprodhim ose në zhvillim.
<b>Toksiciteti specifik për organin e shënjestruar - një ekspozim i vetëm</b>	I paklasifikuar.
<b>Toksiciteti specifik për organin e shënjestruar - ekspozim i përsëritur</b>	Shkakton dëmtime të organeve përmes ekspozimit të zgjatur ose të përsëritur.
<b>Rrezikshmëria në aspirim</b>	Nuk ka rrezikshmëri në aspirim.
<b>Simptomat</b>	Pluhurat mund të irritojnë rrugët e frymëmarrjes, lëkurën dhe sytë. Mund të shkaktojë një reaksion alergjik të lëkurës. Dermatit. Urtikarie.

## 12. Të dhëna ekologjike

<b>Ekotoksiciteti</b>	I dëmshëm për gjallesat ujore me efekte afatgjata.
<b>Persistenca / degradueshmëria</b>	Nuk ka të dhëna në lidhje me degradueshmërinë e përbërësve të përzjerjes.
<b>Bioakumulimi</b>	Nuk disponohen të dhëna.
<b>Mobiliteti</b>	Nuk ka të dhëna për këtë produkt.
<b>Efekte të tjera të padëshiruara</b>	Nga ky komponim nuk pritet të vijnë efekte të tjera mjedisore të padëshiruara (p.sh. dëmtim i ozonit, potencial për krijimin fotokimik të ozonit, çrregullime endokrine, potencial për ngrohjen globale).

## 13. Sugjerime për eliminimin

<b>Mënyrat e eliminimit</b>	Mblidhni dhe dorëzoni ose depozitoni në enë të mbyllura në një pikë të licencuar për eliminim të mbetjeve. Mos lejoni që ky material të kullojë në kanalet e ujërave të zeza/të furnizimit me ujë. Mos ndotni pellgjet, vijat e ujit ose kanalet kulluese me kimikatin ose me enën e përdorur. Eliminoni përmbajtjen/ enën në pajtim me rregulloret lokale/ rajonale/ kombëtare/ ndërkombëtare.
<b>Mbetja nga mbeturinat/ produktet e papërdorura</b>	Eliminoni në pajtim me rregulloret lokale. Enët e zbrazëta ose mveshjet mund të ruajnë disa mbeturina të produktit. Ky material dhe ena përkatëse duhen eliminuar në mënyrë të sigurt (shihni: Udhëzimet për eliminimin).
<b>Ambalazhi i ndotur</b>	Meqë enët e zbrazura mund të përmbajnë mbeturina të produktit, ndiqni udhëzimet e etiketës edhe pasi të jetë zbrazur ena. Enët e zbrazura duhen çuar te një pikë e miratuar për trajtimin e mbetjeve, ku të riciklohen ose të eliminohen.

## 14. Të dhëna për transportin

<b>ADR</b>	Nuk rregullohet si mall i rrezikshëm.
<b>RID</b>	Nuk rregullohet si mall i rrezikshëm.
<b>IATA</b>	Nuk rregullohet si mall i rrezikshëm.



# DËFTESA E SIGURISË TEKNIKE

## IMDG

Nuk rregullohet si mall i rrezikshëm.

**Transportim masiv sipas Aneksit II të** Nuk zbatohet.  
**MARPOL 73/78 dhe Kodit IBC**

## 15. Të dhëna normative

## 16. Të dhëna të tjera

### Mohim i përgjegjësisë

Olympus nuk mund të parashikojë të gjitha rrethanat në të cilat mund të përdoret ky informacion dhe produkti përkatës, ose produktet e fabrikantëve të tjerë në kombinim me këtë produkt. Është përgjegjësi e përdoruesit që të sigurojë kushte të mira sigurie për trajtimin, ruajtjen dhe eliminimin e produktit dhe për të marrë mbi vete përgjegjshmëri për çdo humbje, lëndim, dëm ose shpenzim që rrjedh nga përdorimi i papërshtatshëm. Informacioni në këtë dëftesë u hartua në bazë të njohurive më të mira ekzistuese dhe të eksperiencës më të mirë aktualisht në dispozicion.

### Lista e shkurtimeve

Nuk disponohet.